

Visar Haxhibeqiri dhe Shefqet Istogu

Bernard Tschumi

"Transkriptet e Manhattan-it"

*Analiza, Kritika dhe Shtjellim i kësaj teorie në kontekstin,
kushtet dhe rrethanat e Qytetit të Prishtinës*

Prishtine, Shkurt 2012

Hyrje

"Qysh se shkenca nuk u zë besë shpjegimeve të përgjithshme dhe zgjidhjeve që nuk janë sektoriale dhe të veçanta, sfida e madhe për arkitekturën është të dijë të ndërthurë dijet e ndryshme dhe kodet e ndryshme në një vizion të shumëfishtë e të shumanshëm të botës. " ¹⁾

Ky punim, tenton ta elaburoj Teorinë e Tchumit, ku shtjellimi i kësaj teme, ka një arsytim të veçantë të shqyrtuar dhe të argumentuar në rastin konkret, tashme jo sikurse shpjegon *Tchumi* në rastin e *Manhatanit*, por të njëjtin eksperiment e kemi zhvendosur në kontekstin, kushtet dhe rrethanat e qytetit të Prishtinës. Do të thotë qëllimi parësor është bartja e eksperiencave të *Tchumi-t* (metodologjia dhe filozofia e tij në mënyrën e re të leximit të qytetit), nga Manhatan-i në Prishtinë. Ekziston mundësia e tërheqjes së paraleleve në mes të këtyre dy qyteteve gjithmonë sipas këndvështrimit të Tchumit, ku sipas Tchumit "Arkitektura (e aq me shume qyteti ²⁾) nuk përfaqëson vetëm një formësim hapësinor, por paraqet edhe ngjarjet dhe veprimet që ndodhin brenda asaj hapësire", atëherë ky punim (eksperimentim) tenton që ta jetësojë-vërtetojë teorinë (filozofinë) e *Tshumi-t* që si e tillë vlen edhe për qytetet e tjera (Prishtinën), për të vetmin fakt që shumica e qyteteve të botës kanë: Parqe (MT1); Rruge (MT2); Ndërtesa (MT3) dhe Blloqe banimi (MT4), me një fjale shumica e qyteteve të botës përbëhen dhe ekzistojnë, përpos tjerash, edhe në saje të këtyre katër *Transkripteve*.

I tërë punimi është i ndarë në tre kapituj. *Kapitulli i parë* ka të bëjë me shtjellimin dhe kuptimin fillimisht të teorisë së (leximit) projektimit me metodologjinë e njohur si "*Transkriptet e Manhatanit*"³⁾ të Bernard Tchumit. Kapitulli i dytë, përmban një kritikë të Teorisë në fjale nga Nikos Salingaros⁴⁾ bërë teorisë së Bernard Tchumi-t. Dhe kapitulli i tretë, e njëherit dhe më i rëndësishmi, paraqet orvatjet, në leximin e Qytetit të Prishtinës sipas teorisë së Tchumi-t, pra të *Transkripteve*.

1) "Riciklim informatash dhe vizuelizim i tyre" Visar Haxhibeqiri, "A+P" nr.9 fq. 28 - Reviste shkencore për Arkitekture dhe Planifikim Urban, Polis, Tirane, 2011.

2) E shtuar nga autori i punim, duke dashur të bëjë një përgjithësim më të madh - jo vetëm në oazat e arkitekturës (objektit) por edhe të urbanizmit (qytetit).

3) "*The Manhattan Transcripts*" Bernard Tschumi, (New Edition) (Academy Editions, London, 1994) fq. 31

4) Nikolas Salingaros – matematikan grek, i njohur për punën e tij në teoritë urbane dhe arkitektonike.

1. Bernard Tschumi "Transkriptet e Manhattan-it" 1981

Transkriptet e Manhattan-it ndryshojnë nga vizatimet arkitektonike për aq sa ato nuk janë as projekte reale e as fantazi e thjeshtë. Ato paraqesin një interpretim arkitekturor të realitetit dhe qëllimisht, në *transkripte* përdoret një strukturë e veçantë ku me anë të fotografisë ose përmes një dëshmitari, përshkruhet një ngjarje e caktuar. Qëllimi i *Transkriptit* është që të paraqet gjërat larg përfaqësimit konvencional, përkatësisht paraqet marrëdhëniet komplekse mes hapësirës dhe përdorimit të saj, në mes të "tipit" dhe "programit", në mes të objekteve dhe ngjarjeve. Pra, qëllimi i tyre (*transkripteve*) është kuptimi (leximi) i qytetit të shekullit të XX-të

Transkriptet e Manhattan-it përshkruajnë një interpretim arkitektonik të realitetit. Ato janë të ndara në katër seksione: *park, rrugë, kulla dhe bllok*⁵⁾. Tema dominuese e *Transkripteve* është një grup i "*shkëputjeve*" ku me anë të përdorimit të formave e vlerave sociale, paraqitet një relacion i të kuptuarit dhe i të qenit, i lëvizjes dhe i hapësirës, njeriut dhe objektit, dhe mu kjo u cilësua si pikënisje e fillimit të punës në përpilimin e kësaj metodologjie. Megjithatë konfrontimi i pashmangshëm i këtyre termave, prodhuan efektet e largësisë. Në "*Transkriptet e Manhattan-it*", Tschumi përpiqej që të përdorte koncepte të reja kinematografike, si nocionet e inkuadrimit dhe renditjen në konfigurimin e tre elementeve themelore të arkitekturës: *lëvizja, hapësira dhe ngjarjet*. Ne mund të shohim në këto imazhe ku Tschumi kishte krijuar një ballafaqim të tre elementeve arkitektonike dhe në të zbatohet një lloj i ri i marrëdhënieve midis tyre si pasoje e përvojës kinematografisë.

Sipas Tschumit: "Arkitektura nuk përfaqëson vetëm një formësim hapësinor, por paraqet edhe ngjarjet dhe veprimet që ndodhin brenda asaj hapësire"⁶⁾.

5) *Bllok*- është fjala për *Bllok Banimi*, e jo *Bllok (tulle) muratimi*


6) "*The Manhattan Transcripts*" Bernard Tschumi, (New Edition) (Academy Editions, London, 1994) fq. 23

- **LLOGARIA PROGRAMATIKE**


Episodi i parë (MT1) - "Parku"- është i përbërë nga ilustrime njerëzish si dhe me fotografi të ndryshme që pasqyrojnë një vrasje. *Formula e komplotit të vrasjes* – e cila ilustrohet me figura drerësh, vrasje, gjueti, gjurmime, etj. shfrytëzohen për ndërtimin e të dhënave, deri në përpilimin e një ngjarjeje ekstreme si ajo e vrasjes. Një simbol i veçantë është principi i *sipërfaqes së tre-katrorëve* që nënkupton lojën e fshehur vdekjeprurëse në mes të të dyshuarit dhe ndryshimit të atmosferës arkitektonike, në të cilën direkt ndikon kjo vrasje. Nga fotografitë që pasqyrojnë lëvizjen e aeroplanit i cili zbulon manifestimet mizore, janë nxjerr diagramet kryesore. Në këto skica, sikurse dhe në ngjarjen e treguar, qëndrimet, përshkrimet e planeve dhe lëvizjet janë të lidhur në mënyrë të pazbërthyeshme. Vetëm së bashku përcaktojnë hapësirën arkitektonike të *PARKUT*.

- **MT2 - PARKU**

"Kufiri I braktisur në rrugë nga hotelet luksoze; shitësit e drogës dhe detektivët, shtëpi publike të lira dhe rrokaqiej me shkëlqim, të gjitha ishin pjesë e kësaj bote. Pra, kur ai doli nga burgu , ai mendonte se mund të shkonte i sigurt nga njeri tek tjetri Por Ai e takoj Atë. Për Atë, Ajo ishte sa e guximshme aq edhe e ndrojtur, e papërmbajtur, dhe fëmijërore dhe nga ana tjetër enigmatike. Nga momenti që Ai e pa Atë, ai u çmend kur kuptoi që kjo grua kaq e bukur ishte vdekjeprurëse për dashurinë. RRUGA" ⁹⁾



9) "The Manhattan Transcripts" Bernard Tschumi, (New Edition) (Academy Editions, London, 1994) fq. 23





- **LLOGARIA PROGRAMATIKE**

Ndërsa MT1 gjen origjinën e vet në *Central Park të New York-ut*, MT2 bazohet në një rrugë tipike si "42 STREET". Nga lumi Lindor në *Hudson*, ka rreth dymbëdhjetë botë të ndryshme, duke filluar nga ndërtesa e *Chrysler-it*, pastaj shtëpitë e lira publike; nga *Briant Park* tek *Gërmadhat* e braktisura. Megjithatë, MT2 nuk e përshkruan tërë këtë botë, por janë kufijtë që e përshkruajnë atë. Çdo kufi përbënë një hapësire me ngjarjet e veta të cilat e përshkruan atë. "Ai del nga burgu; ata bëjnë dashuri; ajo e vret atë; ajo është e lirë".

- **MT3 - NDERTESA**

"VJESHË Në fillim vetëm një fëmijë goditet, vargu i qelive të burgut, pastaj e tërë ndërtesa. Vala e përhapjes së lëvizjes, selektive dhe e papritur, duke kërcënuar t'a gëlltitë tërë qytetin me valën e kaosit dhe tmerrit përveç nëse Por, çfarë mund të bëjë ajo Tani që udhëtimi me ashensor ishte shndërruar në një garë trishtuese me vdekje të dhunshme. NDERTESA" ¹⁰⁾

10) "The Manhattan Transcripts" Bernard Tschumi, (New Edition) (Academy Editions, London, 1994) fq. 25-30



• **LLOGARIA PROGRAMATIKE**


Në MT3- *Ndërtesa dhe Vjeshta* - shtëpi, zyra, burg, azil, gjejmë një emërtues të përbashkët, një vjeshtë vdekjeprurëse për njërin nga të burgosurit. Ky manipulim i programeve ka një efekt anësor: në mënyrë të pashmangshme kjo vë në pikëpyetje natyrën e hapësirës që përmbajnë ato. Seti i vizatimeve përshkruan fluturimin e dikujt dhe rënien pasuese nga lartësia e një blloku apo kulle në Manhattan. Ndryshimi drastik i perceptimeve të shkaktuara nga rënia është përdorur për të shqyrtuar transformimet e ndryshme hapësinore dhe shtrembërimet e tyre tipologjike. Nëse pjesët 1 dhe 2 të transkriptit lirshëm krahasohen me paqartësitë e komplotit me ato të arkitekturës, pjesa 3 diskuton metodën e analogjisë, një opozitë dhe përforcim në kuadër të marrëdhënieve nëpërmjet programit dhe llojit.

- **MT4 - NDERTESA**

"Është një bllok me oborret e tij të lira, ky është një imazh i pamëshirshëm, i veshur si ushtar, i pasur, me dukje të një pehivani ... Ku lojtarët e trashë të futbollit fituan një lloj gabimi nga forca e kraharorit të valltarëve ... ku çdo gjë që ju doni të fitoni i takon dikujt tjetër dhe mënyra për ta marrë atë është e paligjshme, e pamoralshme, apo vdekjeprurëse. BLOKU" 11)



11) "The Manhattan Transcripts" Bernard Tschumi, (New Edition) (Academy Editions, London, 1994) fq. 25-30



- **LLOGARIA PROGRAMATIKE**

Në MT4 – BLOKU – Një bllok i thjeshtë qyteti me pese oborre të brendshme. Një ngjarje, dëshmitar, kontradiktë dhe pamundësi programore, akrobat, patinazhistë, kërcimtar, ushtarë dhe lojtarë futbolli. Mblidhen të gjithë këta duke përformuar lojë me një dramacitet kontekstual të pazakontë. Shkëputjet në mes të lëvizjeve, programeve dhe hapësirave, ku secili ndjekë një logjikë të veçantë, si dhe konfrontimet e tyre mes vete, prodhojnë kombinime të pamundura.

1.2. Përfundime dhe konkluzione

- **Klasifikimi**

Transkriptet ofrojnë një lexim të ndryshëm të arkitekturës, në të cilën hapësira, lëvizjet dhe ngjarjet janë përfundimisht të pavarura, dhe njëkohësisht qëndrojnë në një lidhje të re me njëra-tjetrën, në këtë mënyrë që komponentët konvencionale të arkitekturës janë shkatërruar dhe rindërtuar përgjatë akseve nga eksetet e ndryshëm.

- **Marrëdhëniet**

Transkriptet pretendojnë të tregojnë/provojnë së vetëm lidhja e habitshme ne mes tri niveleve: *lëvizjes, ngjarjes, dhe hapësirës* mund të jetë pjesë e përvojës arkitektonike. Por ato asnjëherë nuk bëjnë të pamundurën që të kapërcejnë kontradiktat midis *njeriut, objektit dhe ngjarjes* duke i sjell ato në një sintezë të re: por perkundrazi, ato synojnë të mbajnë këto

kontradikta në mënyre dinamike dhe një lidhje të re indiferente, reciproke apo konfliktuozë...

- **Realiteti**

Origjina e realitetit arkitektonik në çdo episod është gjetur brenda një realiteti të veçantë dhe jo në një figurë abstrakte gjeometrike. *Manhattan* është vend i vërtetë; veprimet që përshkruhen janë veprime reale. Te *Transkriptet* gjithmonë presupozohet një realitet që tashme ekziston, një realitet në pritje të prishet - dhe transformohet përfundimisht. Ato izolojnë imazhe, elemente të marra nga qyteti. Megjithatë, roli i *transkriptit* nuk është rol përfaqësues, dhe kjo i përjashton nga të qenit imitues. Pra, në të njëjtën kohë ngjarjet e përshkruara nuk janë ndërtesa reale ose ngjarje me subjektivitet të distancuar, por, janë temat e *transkriptit*. Kështu që realiteti i kësaj *sekuence* nuk krijon pavërtetësinë e *transkriptit* në botën e jashtme, por në logjikën e brendshme që këto sekuenca shfaqin.

- **Simboli**

Qëllimi i trinomit (ngjarje, lëvizje, hapësirë) është të paraqes hierarkinë e eksperiencës, kohës, lëvizjes, sekuençave, dhe e të gjitha mënyrave që ndërhyjnë në leximin e qytetit. Ato gjithashtu rrjedhin nga përvoja e gjuhës reprezentative të arkitektëve: *planët, prerjet, aksionometria, perspektiva...*

- **Artikulimi**

Transkriptet e Manhattan-it nuk janë akumulim i ngjarjeve të rëndomta, ato shfaqin një organizim të veçantë. Karakteristikë e tyre e veçantë është sekuenca, një seri imazhesh që konfrontojnë *hapësirën lëvizjen dhe ngjarjet*, secila me strukturën e vet kombinuere të vendosura sipas rregullave.

- **Transformimet**

Sekuencat nga transkriptet shumëfishohen/intensifikohen përmes përdorimit të instrumentëve/mjeteve, apo metodave transformuese p.sh. kompresimit, shtimit, transferimit, etj...

- **Kombinimet**

Duke shkuar përtej definicionit tradicional të "funktionalizmit", *Transkriptet* përdorin nivelin e tyre të hetimit në kombinime, për të trajtuar nocionin e programit – një ideologji që në fushëveprimin arkitektonik është harruar për dekada të tëra...

- **Dekonstruktimi**

Pavarësisht nga abstraksioni i mekanizmave të tyre, transkriptet përgjithësisht presupozojnë një realitet tashmë ekzistencial, një realitet në pritje për t'u dekonstruktuar dhe transformuar përfundimisht. Ato izolojnë elementet e marra nga imazhet e qytetit (Megjithatë roli i transkriptit nuk është përfaqësuar, ata nuk janë imitues)

- **Ndjesitë**

Nëse programet e përdorura për *Transkriptet* e Manhattan-it kanë natyrë ekstreme është për tu nënvizuar fakti se ndoshta e gjithë arkitektura, në vend së të filloj një lidhje standarde funksionale, gjithçka është rreth dashurisë dhe vdekjes...

2. Kritika e teorisë së Tchumit nga Nikos Salingaros ¹⁾

Kjo është një seri e kapitujve nga një ese që tregon kuptimin e teorisë bashkëkohore arkitektonike. Unë do të diskutojnë disa aspekte të deconstructivism, me theks të veçantë mbi kontributet teorike të Bernard Tschumi.

3.1. Teoria Arkitektonike

Në mënyrë që të diskutohet ndonjë supozim që kontribuon në teorinë arkitektonike, është e nevojshme të përcaktojmë çfarë teorie arkitektonike është. Një teori në çdo disiplinë, është një kuadër i përgjithshëm që (1) shpjegon fenomenet e vërejtura, (2) parashikon efekte që shfaqen nën rrethana të caktuara, dhe (3) mundëson krijimin e një situate të paparashikuar nga teoria. Në arkitekturë, një kornizë teorike shpjegon pse objektet ndikojnë tek njerëzit në mënyra të caktuara, dhe pse disa ndërtesa janë më të suksesshme në aspektin praktikë, gjithashtu edhe në terma psikologjike dhe estetike. ¹⁾

Mejshtërisht, arkitektura vetëm tani hynë në formulimin e bazes teorike pas një rrugëtimi të gjatë. Ky nuk është ekzagjrim që thuhet se deritani, tereni ka qenë i shtyer nga tekët personale dhe moda, por asnjëherë i mbështetur në themele teorike. Si rezultat i një keqkuptim të rëndë (për shkak të injorancës shkencore nga tre breza të arkitektëve ²⁾), një sasi voluminoze e shkrimeve ka qenë e gabuar në "teorinë arkitektonike", edhe pse kjo mendohet se nuk është e tillë. Ky material është mësura nga studentët e arkitekturës, dhe është studiuar e praktikura nga arkitektët, megjithatë, ajo shërben vetëm për të promovuar modelet e caktuara stilistike dhe jo formës arkitekture. Teoritë mjaft të vërteta të cilat kanë forcuar bazen arkitekturës janë paraqitur në shkrimet e Christopher Alexandrit, Leon Krier, dhe disa të tjerë.

Arkitektët kanë vështirësi në vlerësimin e teorisë së mirëfillt arkitektonike, dhe shkaktojnë anomali në përmbajtjen e teksetve ekzistuese arkitektonike ³⁾. Autorët duke pretenduar për të shpjeguar format arkitektonike përmes teorive shkencore dhe fjaloreve të tyre janë padyshim të hutuar, dhe kështu ngatërrojnë lexuesit.

Kjo për fat të keq ndodh sepse në arkitekturë, nuk ka ende asnjë baze për të gjykuar në mes të një të vërtete dhe një teorie të rreme.

1) Christopher Alexander, S. Ishikawa, M. Silverstein, M. Jacobson, I. Fiksdahl-King & S. Angel, A Pattern Language (Oxford University Press, New York, 1977).

2) Christopher Alexander, The Phenomenon of Life: The Nature of Order, Book 1 (The Center for Environmental Structure, Berkeley, California, 2001).

3) Leon Krier, Architecture: Choice or Fate (Andreas Papadakis, Windsor, England, 1998)

Fushat e tjera ishin në gjendje të zhvillojnë bazat e tyre teorike vetëm pasi ata krijuan një kriter vlerësimi, duke vendosur një mekanizëm për analizën e pakuptueshmërisë⁴⁾. Arkitektët gabimisht besojnë në një seri kriteresh që ekzistojnë tek shkencat egzakto siç është fizika, pa e kuptuar se edhe arkitektura në vetvete ka një fushë eksperimentale.

3.2. Teoritë e Bernard Tschumit

Dy teoritë më të rëndësishme të Tschumit janë: “Transkriptet e Manhattan-it” (**The Manhattan Transcripts**) dhe “ Arkitektura dhe Shkëputjet” (**Architecture and Disjunction**). Është pikërisht teoria “Transkriptet e Manhattan-it” që e ndihmon Tschumin të bëhet Dekan I shkollës së arkitekturës në Univerzitetin Kolumbia. Teoria përshkruhet nga fotografitë bardh e zi dhe skicat e bëra nga autori. Ato paraqesin karikatura të ndërtesave të shtrëmbëruara dhe të thyera. Mesazhi I tyre është I paqartë sic është edhe marëdhënja e tyre me tekstin. Transkriptet e Manhattan-it përshkruajn një burrë famkeq duke u hedhur nga dritarja që përshkruhet në tekstin në vijim:

“Për të rritur vlerat e arkitekturës, ju ndoshta duhet të kryeni ndonjë vrasje”⁵⁾

Unë nuk shoh këtu ndonjë teori që shpjegon ose parashikon efektet e ndryshimeve në formën arkitektonike. Nëse kjo nuk është teori arkitektonike, atëherë ne kemi nevoj për të zbuluar saktësisht së çfarë teksti shtjellon. Natyrisht kjo nuk ka të bëjë asgjë me arkitekturën, por kjo ka ndikuar për krijimin e një ambient psikologjik të zymët, e që është vendimtar në projektim⁶⁾.

Nëse unë isha I nxitur për të paraqitur një mesazh në këtë teori (dhe nëse ky është domosdoshmërisht opinjon subjektiv) unë do të thoja së këto transkripte paraqesin dhunë ; gjithashtu edhe projektet e tilla paraqesin dhunë në ndërtesa⁷⁾. Ky është në fakt mesazhi visual I koduar në vizatimet e treguara tek Transkriptet. Format të cialt identifikohen objektet/ndërtesat janë të thyera të shtrembuara dhe të shpërndara; elementet e tyre përbërese lënë përshtypjen e paqendrueshmërisë. Imazhet te cialt e paraqesin këtë teori në shikim të parë janë të pakuptimëta dhe kanë mesazhin e qartë, cthurrjen e një strukture koherente. Këto imazhe kanë një cilësi të veçantë, ato godasin mendjen e lexuesit.

4) Nikos Salingaros, A Theory of Architecture (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).

5) Bernard Tschumi, The Manhattan Transcripts (New Edition) (Academy Editions, London, 1994; First Edition, 1981)

6) Nikos Salingaros, A Theory of Architecture (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).

7) Nikos Salingaros, "The Sensory Value of Ornament", Communication & Cognition, Vol. 36, No. 3/4 (2003). Chapter 12 of A Theory of Architecture (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).

“Transkriptet e Manhattan-it” nuk prezantojnë aq shumë teorinë arkitektonike, ato më shumë prezantohen si koleksion i iamzheve të destinuara për marketing (reklamë) ⁸⁾.

Integrimi i konceptit të dhunës në mekanizmin arkitekturor – qëllimi i argumentimit – ka për synim që në fund të fundit të paraqes një kënaqësi të re arkitektonike ⁹⁾. Ashtu si çdo formë e dhunës, dhuna në arkitekturë përmbanë mundësinë e ndryshimit, të rinovimit ... dy lloje të dhunës së pjesëshme duhet të dallohen ... dhuna programatike përfshinë: përdorime, veprime, ngjarje dhe programe të cialt, rasteshisht ose me dashje janë të këqija dhe dekonstruktive. Midis tyre ka vrasje, internim dhe toritura të cilat thekësohen në kampet e përqendrimit ose dhoma të torturës ¹⁰⁾.

Tschumi tërheq një paralele në mes të varësisë seksuale dhe arkitekturës:

“ Në mënyrë të ngajshme, loja e arkitekturës është një lojë e ndërlikuar me rregullat që mund ti pranojmë ose ose refuzojmë ... këto rregulla përmbajnë shume nyje që nuk mund të zgjidhen, në perqijthësi janë një pengesë e porealizuar. Ajo qka është e rëndësishme këtu është se nuk eqziston një teknikë e thjeshtë e varësisë seksuale.”¹¹⁾

Libri i Tschumi-t është bërë më terheqës duke futur citate nga Marquis de Sade “ Mbi Praktikën e Pazakonta Seksuale” p.sh. ai rishqyrton zgjidhjen e menqur të De Sade-s ku përshkruan në të njëjtën kohë plaqkitjen e një tempulli me një akt seksual. (faqe 128).

Nëse lexohet si teori arkitektonike, kjo nuk ka kuptim, por në kuadër të asociacionit të psikologëve kontribuon në formulimin dhe përforcimin e një mesazhi të caktuar.

3.3. Asocimet Psikologjike në tekstet e Tschumit

Tentimi për të treguar diçka në shkrimet e Tschumit është shumë frustruese, por është diçka që unë dua ta theksoj. Në “Arkitektura dhe Ndarjet” (Faqe 187) ne jemi duke ofruar një përshkrim gjoja shkencor të projektimit të Park de La Villette. Qëllimi i këtij projekti ishte që të aplikoj konceptin teorik në një park, për të lëvizur nga matematika e pastër të përshkruar në teorinë “Transkriptet e Manhattan-it” në matematikën aplikative ... Strategji tjetër e përfshirë në këtë proces është mënjanimi i disa faktorëve të paprecedent dhe krijimi i një konfiguracioni neutral matematikor apo konfiguracioni ideal topologjik (rrjetet, sistemet lineare ose koncentrike, etj) që mund të bëhen si pikënisje për

8) Nikos Salingaros, "The Derrida Virus", TELOS No. 126 (2003), pages 66-82.

9) Nikos Salingaros, A Theory of Architecture (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).

10) Nikos Salingaros, "The Sensory Value of Ornament", Communication & Cognition, Vol. 36, No. 3/4 (2003). Chapter 12 of A Theory of Architecture (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).

11) Bernard Tschumi, Architecture and Disjunction (MIT Press, Cambridge, Massachusetts, 1994).

transformimet e ardhshme. Përsëri në(faqe 197):

“La Villette ishte ndërtim I zqjeruar I një metode krahasuese, ajo ishte e shtyer nga dëshira për të lëvizur nga "matematika e pastër në matematikën e aplikative.”¹²⁾



Matematika e aplikuar?

Tani, përpos së jamë një teoricient I arkitekturës, gjithashtu jamë edhe professor I Matematikës, dhe nuk po gjej asnjë përmbajtje të dukshme matematike (të pastër apo aplikative) në shkrimet dhe objektet e tschumit¹³⁾.

Një gjë mund ti përshkruaj ndërtesat e Tschumi-t (ndonse ai vetë nuk e bënë këtë) dhe konsiston në paraqitjen e disa lëshimeve të qëllimshme, por selective përgjat përzgjedhjes së formave të aplikuara.

Dizajnet e tij shkaterrojnë rendin e arritur, përshkak të përsëritjes së një nënsimetrije; ai nuk e renditë këtë simetri për të dëfinuar parçialisht strukturën në mënyrë jokohërente. Thyerja e lidhjeve vitale dhe simetrisë në mes të pjesëve përbërëse shkonë deri në dhunë, në drejtim të shthurjes së pastërtisë matematikore në formë koherente. Ku prishja drastike e lidhjeve të brendshme vret organizmat biologjik¹⁴⁾.

Në “ Arkitektura dhe Shkëputjet” Tschumi tashme kishte përmbledhur iden e tij themelore:

“Koncepti I dhunës gjithashtu sugjeron lexime të ndryshme të funksionit hapësinor – që përcaktimi I arkiteëkturës mund të qendroj në kryqezimin e logjikës dhe dhëmbjes, racionalitetit dhe ankthit, konceptit dhe kënaqësisë” (faqe XVIII).¹⁵⁾

Ky ndoshta është celësi I të kuptuarit se cka më të vërtetë është duke ndodhur. Psikologji eksitimi, ankth, nxitje sensual (sidomos efektet e shkaktuara nga kënaqësitë e ndaluara e të kombinuara me dhunë seksuale).

12) Bernard Tschumi, *The Manhattan Transcripts (New Edition)* (Academy Editions, London, 1994; First Edition, 1981)

13) Nikos Salingaros, "The Derrida Virus", TELOS No. 126 (2003), pages 66-82.

14) Nikos Salingaros, "The Sensory Value of Ornament", *Communication & Cognition*, Vol. 36, No. 3/4 (2003). Chapter 12 of *A Theory of Architecture* (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).

15) Bernard Tschumi, *Architecture and Disjunction* (MIT Press, Cambridge, Massachusetts, 1994).

Unë nuk kam përcaktuar ndonjë mënyrë të kritikës, dhe nuk e di se çfarë Tschumi dëshiron të kumtoj. Megjithatë, tema e dhunës është e dukshme në tërë punën e tij. Ai paraqet një fotografi ku një person bie nga dritarja të "Transkriptet e Manhattan-it". Kështu që në "Transkriptet e Manhattanit" kame njohur dy tronditje: imazhet revoltuese nga viti 1928 në filmin e Luis Bunuel dhe Salvador Dal-in në filmin "Um Chien Andalou", ku syte e një gruaje të re janë hapur me një brisk (faqe 158). Këto imazhe janë paraqitur përseri në teorinë "Arkitektura dhe Shkëputjet" (faqe 158), prandaj Tschumi duhet ti konsidëroj këto imazhe më një rendësi të përgjithshme. A është kjo mënyra për të thënë së në ditët e sotshme, " prerjet/cutting-edge" fjalë-për-fjalë në arkitekturë do të thojnë të njëjtën gjë si në filmin e Luis Bumuel?

Për të future një stil të ri arkitektonik, duke importuar imazhe të një tipologjie të veçantë në mendjen e arkitektit. E gjithë kjo dhunë grafike, e cila është e nënkuptur dhe e sygjëruar në shkrimet e Tschum-it e ka kuptimin e interpretimit në mënyrë të caktuar. Tschumi këtë nuk e shpjegon por në qoftë së është e vërtetë, atëherë kjo do të shëndërrohet në një mashtrim të shkëlqyres psikologjik¹⁶⁾.

Mund të jetë(këtu unë supztoj) që dhuna/ erotica në tekste e Tschumit shërben për të rregulluar imazhet e tij të formave të përbëra në ndërgjegjje tonë , kështu që ne disi ti pranonim ato¹⁷⁾.

Sipas Tschumit: ... Kënaqësia ime kurrë nuk ka dalë në sipërfaqe nëpërmjet pamjes së një ndërtese, por përmes çmontimit të tyre. "Arkitektura dhe Shkëputjet" (faqe: 210)

A janë të shqetësuar klientet e tij nëse e kanë lexuar këtë deklaratë? A do ta përcjellë një ndjenjë e këndshme arkitektin e zgjedhur te muzetu përball Partenonit? Për më tepër kjo deklaratë është e një arkitekti intelektual, ku me c' rast studentet e tij mund të ndikohen nga kritika e tij ; Por këtu askush nuk mund ti vë faj atij. Cdo kritikë duhet të drejtohet në ato institucione të cilat i kanë porositur veprat e tij dhe kanë mundësuar përhapjen e mesazhit të tij. Ose ndoshta ndoshta, qytetrimi ynë ka arritur që të pranoj një arkitekture që bënë dhunë për të formuar një vend koherent¹⁸⁾.

16) Nikos Salingaros, "The New Acropolis Museum,"

17) Po aty,

18) Po aty,




Duke kërkuar trillerin arkitektonik

Cdo strukturë e përshtatshme, e cila domosdo i lidhë pjesët e saj përbërese me njëra-tjetrën, duhet të duket e kompozuar me kontekstin egzistues. Emocioni i dhunës, duhet të jetë shkaktuar nga thyerja ose shkatërrimi i një struktura të presupozuar, me c' rast kjo cilësi mungon krejtësisht në arkitekturën tradicionale¹⁹⁾.

3.4. Vlefshmëria institucionale mbi punën e Tschumit

Dizajni dekonstruktiv i propozuar në një far mënyre prishë koherencën e mishëruar në arkitekturën tradicionale në shumicën dërmuese të objekteve egzistuese. Ndërtesat dekonstruktive nuk bëjnë asnjë përpjekje për tu lidhur/kompozuar me kontekstin përreth. Tschumi imiton një relacion midis arkitekturës dhe dekonstruktivizmit francez, duke aplikuar udhëzimet e Jacques Derrida-s në pavilionet e “Le Parc de la Villette” ndërtuar në periferi të Parisit²⁰⁾.



Muzeu i Akropolit të Ri (New Acropolis Museum)

Teoritë e Tschumit janë vlerësuar shumë nga profesionistët nga fusha e Arkitekturës. Arkitektët vazhdojnë të lexojnë teorinë e tij, ndërsa mësuesit i rekomandojnë ato tek studentet e tyre. Cdo kush ka të drjetë të shkruaj çfarë të dëshiroj, por kur asociacionet e arkitekteve, univerzitetet tona më të mëdha, institucionet qeveritare lavdërojnë dikë që është arkitekt “Cutting-edge” (nëse shprehem figurativisht), atëherë i tërë sistemi është

përgjegjës. E tërë barra bie mbi institucionet. Madje qeveritë e huaja kanë angazhar atë në projektimin e ndërtesave më rëndësi të madhe sic janë: Parc de la Villette nga qeveria franceze, dhe “Museu i Akropolit të Ri” nga qeveria greke. Kjo ngre një pikëpyetje në sistemin tonë të arsimit. Si të mos jetë një student i frikësuar intelektualisht kur sheh një prej objekteve të Tschumit, ndërsa qeveritë e sponsorjonë ndërtimin e një muzeu prestigjioz kombëtare të hartuar prej tij. A mundet dikush të gjykojë në mënyrë kritike shkrimet e Tschumit kur ky person është paraqitur si autoritet i padiskutueshëm dhe i mbështetur nga institucionet e nivelit më të lartë²¹.



Le Parc de la Villette

19) Po aty,

20) Nikos Salingaros, A Theory of Architecture (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).

3. Konteksti vendore - Transkriptet e Prishtinës.

Duke u shkëputur paksa nga çka u tha me larte dhe duke dashur t'i largohem përgjithësisht edhe pse me shpjegimeve konkrete, por në rrethana jo aq të njohura për ne (e kam fjalën për Manhattan-in) ne po tentojmë që të njëjtën praktike ta bëjmë më të kapshme, duke e zhvendosur në konditat tona, ne konditat e qyteteve tona, në konditat e Pishinës tonë. I gjithë eksperimenti, ka një arsytim të veçantë të shqyrtuar dhe të argumentuar në rastin e qytetit të Prishtinës, tashmë jo sikurse shpjegoj *Tchumi* ne rastin e *Manhattanit*, por të njëjtin eksperiment e kemi zhvendosur në kontekstin, kushtet dhe rrethanat e qytetit të Prishtinës. Do të thotë *qëllimi parësor* është bartja e eksperiencave të *Tchumi-t* (metodologjia dhe filozofia e tij në mënyrën e re të leximit të qytetit), nga Manhattan-i në Prishtinë. Ekziston mundësia e tërheqjes së paraleleve në mes të këtyre dy qyteteve gjithmonë sipas këndvështrimit të Tchumit, ku sipas Tchumit "*Arkitektura (e aq me shume qyteti* ¹²⁾) nuk përfaqëson vetëm një formësim hapësinor, por paraqet edhe ngjarjet dhe veprimet që ndodhin brenda asaj hapësire", atëherë ky punim (eksperimentim) tenton që ta jetësoj-vërtetoj teorinë (filozofinë) e *Tshumi-t* që si e tillë vlen edhe për qytetet e tjera (Prishtinën), për të vetmin fakt që shumica e qyteteve të botës kanë: Parqe (MT1); Rruge (MT2); Ndërtesa (MT3) dhe Blloqe banimi (MT4), me një fjalë shumica e qyteteve të botës përbëhen dhe ekzistojnë, përpos tjerash, edhe në saxe të këtyre katër *Transkripteve*.

Si çdo qytet i madh, edhe me shume si çdo kryeqytet, Prishtina është e mbushur dhe gumëzhin nga lëvizje të shumta njerëzish, të cilët ecin në drejtime të shumta dhe her her të duket sikur janë nisur diku pa adrese. Të rinj, pleq, të shëmtuar, bukurosh, intelektual, artiste, injorantë, të ceket, të mençur, të urtë, vagabond e lloj lloj struktura njerëzish sheh dhe takon ne rrugët e Prishtinës. (normale, si çdokund tjetër). E gjithë kjo lëvizje me të gjithë këta *aktore*, lehtësisht nga një *shpirt artisti* shihet si një *energji* e cila do të përdoret si shtytje në krijimtarinë e tij. Është e kuptueshme, që Prishtina në vetvete strehon lloj-lloj ngjarjesh të odisejadave nga më të ndryshmet njerëzore. Çdo *Park*, ruan historinë e puthjes së vjedhur në një mbrëmje vere me erë trëndafili, por fsheh edhe plaçkitjen e frikshme me armë të ftohte vjeshtave me shi. Çdo *Rruge*, shkelet nga bukuroshet e llastuara, por fshihet edhe me trupin e një lypësi të gjorë që lëngon nga një sëmundje në shpirt. Çdo *Ndërtesë*, është vendstrehim edhe për *balin*, por strehon njëkohësisht edhe *intelektualin*, dhe së fundmi çdo *Bllok banimi* ka shpirtin e vete, aromën e vet, ka emrin e vet. Njerëzit me historitë e tyre neper hapësirat e *Qytetit* ndërtojnë pa e kuptuar ngjarje që orvaten nëpër ajrin e rënduar të Prishtinës dhe bëhen shtytëse idesh inovative për shpirtat e rinj krijues. Mu këtu zë fill dhe historia e Transkripteve të Prishtinës, që do të shtjellohet më poshtë. Ta lexojmë paradoksin e jetës-*paradoksin e qytetit Prishtina* në *Transkriptet* e tij.


12) E shtuar nga autori i punim, duke dashur të beje një përgjithësim më të madh - jo vetëm në oazat e arkitekturës (objektit) por edhe të urbanizmit (qytetit).

4.1. Apstragimi përshkrimor i katër Transkripteve

- **PRT1 - PARKU GERMIA**


"Hodhi në anën tjetër të krahëve flokët e gjata ngjyrë gështenje, rregulloj për herën e fundit kufjet dhe vazhdoj vrapin. Gjethet, ledhatoheshin nga era e buzëmbremjes së ngrohtë dhe poshtë trungut, dy frymorë shuanin afsh e avull shpirti. <Gëzuar, gëzuar> një mori zërash vogëlushësh në lëndinën e gjelbër, mbi batanijen e kaft e të leshtë, festonin ditëlindjen e shoqes që mungonte. Festonin, e shoqja luftonte me valët e basenit plot ujë. Kishte harrua te notonte, mbase nuk dinte fare,..., harroj të kërkonte dhe ndihmë, mbase nuk mundte... paradoks!!

Gjethja së bashku me një bilete hyrjeje në park, ranë së bashku dhe përnjëherësh në tokë. Që të dyja u shkelen nga rrota e një makine që vraponte edhe pse rrotull njerëzit ecnin të pa bezdisshëm. !!!"



- **PRT2 - RRUGA**

"Një çantë e lustruar, luhatej në dorën e një njeriu të moshuar, me ritmin e njëjtë që dridheshin gjethet e blinit sipri kokës së tij. Plot energji, ecte duke kërcyer, por pa u diktuar, dëgjonte muzikën, por jo edhe zhurmën e makinave. Me mirë e ndalonte zhurmën e makinave duke dëgjuar muzikën. Lëvizjen e makinave i shikonte si filmat e Çarli Çaplinit - pa zë, por i shoqëronte me këngën e Edward Maya - Violet Light. E tejkaloi plakun, i cili ngriti kokën. Nuk i foli, nuk e njohu. Ishte Ai i dikurshmi - mendoj plakun. Unë do t'jem Ky pas shumë viteve - mendoi djaloshi. U step i habitur nga mendimi i tij: Shumë dhe pak nuk janë njësi matëse!!".




- **PRT3 - NDERTESA**

Çdo *Ndërtesë*, është vendstrehim edhe për *balin*, por strehon njëkohësisht edhe *intelektualin*. Nga dritarja e ballkonit që nga ana e brendshme të nxjerr në kthinën e kuzhinës, së bashku me tingujt vulgar që të grithin veshin me këngët turbofolke dhe pseudo kulturore, fluturon dhe një qese përplot mbeturina. *Ndotja akustike* përcjellët e shoqëruar dhe me *ndotjen ambientale*, të cilat së bashku trumbetojnë njollosjen e karakterit të deformuar shoqërorë. Qesja e mbeturinave jo çuditërisht bie para dy palë këpucëve të lustruara për merak. <*S'është hera e parë*> mendoi i zhgënjyer, kësaj here jo nga jeta por nga njerëzit, më saktë, nga sjelljet e tyre.....Kujtoi erën e luleve të blirit rrëzë së cilave kaloi pak me parë, në rrugën nga Fakulteti për në banesë. <*Që sot, e tutje nuk jam më shqiptarë. O Zot bëje mirë Shqipërinë për inat të shqiptarëve*> nga këto degëzime të rrufeshme mendimi, ndjeu qe po nervozohet nga një pezëm, po ai pezëm qe e beri At Gjergj Fishten, të shprehej kështu pikërisht para me se 100 viteve. Kaluar me se 100 vite dhe ne kemi ecë shumë përpara - mendoi duke i ngjitur shkallet e banese, përderisa hundët iu mbushen me erë fasuleje të zier. S'ka si të mos ndodhte ndryshe, për kompletimin e kësaj tabloje domosdo nevojitej edhe *ndotja aromatike*. E qetësoi vetën, ..., <nuk po mundohem kot, Ai që nuk bëhet dot njeri me qumështin e nënës, qumështi i lopës nuk i bën asgjë>.



- **PRT4 - BLOKU I BANIMIT**

.... dhe së fundmi çdo *Blok banimi* ka shpirtin e vete, aromën e vet, ka emrin e vet. "Me trego se me kë rri të të tregoj se cili je". Sot, "Më trego se ku banon të tregoj se cili je". Identitetin ta imponon edhe lagjeja ku banon, Lagjen e mbart gjithmonë sikurse mbartë mbiemrin. *Marigona* me shtëpi një dhe dy katërshe. <Një roje në hyrje më uroj mirëseardhje dhe deri tek dera e shtëpisë për ku isha drejtuar me dukej sikur udhëtoja neper përralla>.....



4. Përfundimi - *Energjitë transformuese të Prishtinës*

Nga skicat, foto dhe vizatimet - të cilat lindën si derivat i shtjellimit të teorisë së Transkripteve, - shndërruan energjinë e ngjarjeve paradoksale, në skema produktive arkitektonike, të gatshme të procesohen si të tilla në *Projekte Konceptuale* të cilat tashmë brenda vetës përmbajnë më shumë se vija - përmbajnë *ngjarjet, tregimet* e jetës në Prishtinë. Jo gjithmonë Prishtina është e trishtë, jo gjithmonë Prishtina shihet me syrin dyshues. Transkriptet më së miri lexuan dhe na treguan që "*trishtimi i Prishtinës*" është energji e fshehur e cila po u ri menaxhua rikthehet si bumerang pozitiv në çdo sferë të jetës e aq më shume në arkitekturë.

Procesi *lëvizje, ngjarje, dhe hapësirë* u përkthye në *vija dhe forma* - të cilat reciprokisht në vetvete janë më shumë se aq. Ato në vetvete përmbajnë ngjarjet/rrëfimin dramatik që zhvillohet në *hapësirën e Qytetit*. Me një fjalë, marrë në përgjithësi, përmbajnë dhe tregojnë - *Rrëfimin për Prishtinën tashmë jo të trishtë. Pasqyrojnë një pështjellim emocional një lëmsh ndjenjash - energjinë transformuese të Prishtinës.*

6. Bibliografia

- Lynch, K. (1990). *Image of the City*. London, England: The M.I.T. Press.
- Cullen, G. (2000) *The Concise Townscape*. Great Britain. Architectural Press
- Zucker, P. (1970) *Town and Square: From the Agora to the Village Green*. M.I.T. Press
- Carmona, M. Heath, T. Oc, T. Tiesdell, S.(2003) *Public Places-Urban Spaces*. Great Britain. Architectural Press
- Carmona, M. Tiesdell, S. (2007) *Urban design reader*. Great Britain. Architectural Press
- De Bure, G. (2003) *B. Tschumi* . New Yourk: Rizzoli.
- Christopher Alexander, S. Ishikawa, M. Silverstein, M. Jacobson, I. Fiksdahl-King & S. Angel, *A Pattern Language* (Oxford University Press, New York, 1977).
- Christopher Alexander, *The Phenomenon of Life: The Nature of Order, Book 1* (The Center for Environmental Structure, Berkeley, California, 2001).
- Nikos Salingaros, *A Theory of Architecture* (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).
- Bernard Tschumi, *The Manhattan Transcripts* (New Edition) (Academy Editions, London, 1994; First Edition, 1981)
- Bernard Tschumi, *Architecture and Disjunction* (MIT Press, Cambridge, Massachusetts, 1994).
- Nikos Salingaros, "The New Acropolis Museum,"
- Nikos Salingaros, "The Derrida Virus", *TELOS* No. 126 (2003), pages 66-82.
- Nikos Salingaros, "The Sensory Value of Ornament", *Communication & Cognition*, Vol. 36, No. 3/4 (2003). Chapter 12 of *A Theory of Architecture* (Umbau-Verlag, Solingen, Germany, in preparation).
- Louis A. Sass, *Madness and Modernism* (Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts, 1992), Chapter 6.
- Deda, L. (2010). *Leksione nga Dizajni Urban*. Tirana: Universiteti Polis.
- Dhamo, MSc. (2009). *Analiza Territoriale*. Tirana: Universiteti Polis.
- Faja, E. Prof. Dr. (2005). *Arkitektura e Pejzazhit*. Tirana: Universiteti UFO.
- FORUM A+P (1-6)*. Tirana: Universiteti Polis (B. Aliaj, S. Dhamo, D. Shutina).

Web faqet:

<http://www.2blowhards.com/archives/001407.html#001407>

<http://www.urbandesigncompendium.co.uk/>

http://placemaking.pps.org/info/newsletter/december2005/us_canada_squares

http://digilander.libero.it/marta_moccia/eisenman_lotta%20al%20cubo.html

<http://architettura.supereva.com/coffeebreak/20001212/idex.html>

<http://www.arc1.uniroma1.it/saggio/diecielode/Tescione/Tescione.html>

<http://thedesignatedsketcher.com/finished/parc-de-la-villette>